REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 181/26 Dt. 10.04.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të Rregullores (QRK) nr. 06/2023 për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimit, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shëndetësisë, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për lejimin e udhëtimit zyrtar

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Shëndetësisë, bazuar në ftesën e Shoqatës së Biznesmenëve dhe Miqësisë Turke-Kosovare (TUKIAD), për lejimin e udhëtimi zyrtar të Sylejman Baxhaku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Levent Bush, drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financa, për pjesëmarrje në Ekspozitën Ndërkombëtare Mjekësore "EXPOMED EURASIA", që mbahet në Stamboll të Republikës së Turqisë, nga data 16 prill 2026 deri me 18 prill 2026, kështu që, për këtë qëllim lejohen udhëtimi zyrtar, pagesa e shpenzimeve të udhëtimit (transportit) dhe mëditjeve, si dhe shpenzimeve të paparashikuara për të lartcekurit, konform, akteve ligjore për udhëtimet zyrtare.

2. Nisja (shkuarja) zyrtare bëhet me datë 15 prill 2026, ndërsa kthimi me 19 prill 2026.

3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në këtë vendim, do të sigurohet nga buxheti i Komunës– pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

4. Obligohet Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

Për:

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shëndetësisë,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Të lartcekurve,
- Arkivës së Kryetarit.